



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

Rasti: Përfitim Kontrolli te perbashket VERBUND International GbmH / EVN AG ne shoqerine Energji Ashta Shp.k.

Në datën 27 Prill 2010, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të kontratës së shitjes së kuotave, të nënshkruar ndemjet palëve (VERBUND International GbmH dhe EVN AG), më datë 20 Prill 2010 me objekt përfitim e kontrollit te perbashket në shoqërinë Energji Ashta Sh.p.k, me anë të transferimit te 50% të kuotave nga VERBUND International GbmH në EVN AG.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- Për VERBUND International GbmH: është pjesë e grupit Verbund, i cili vepron në sektorin ekonomik te energjisë dhe utiliteteve. Veprimtaria kryesore e Verbund është gjenerimi i energjise elektrike, tregtimi, transmetimi dhe shpërndarja e saj;
- Për EVN AG: vepron ne sektorin energjetik/utiliteteve dhe ate mjedisor. Produktet qe EVN ofron ne sektorin energjetik/utiliteteve, përfshijnë energji elektrike, gas, ngrohje dhe shërbime te lidhura. Ne sektorin mjedisor shërbimet e EVN përfshijnë furnizimin me ujë, trajtimi i ujërave, djegie mbetjeve urbane etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al